



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**PLANI VJETOR I FINANCIMIT TË ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA NGA MINISTRI
I DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 15 pika 3 të ligjit nr. 111/ 2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”; Ligjit nr. 137/2020 datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”; Vendimit nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” si dhe shtojcës 1 të Urdhrit nr. 226, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti” ndryshuar me Urdhrin nr. 424 datë 18.12.2020, të Ministrit të Drejtësisë, “Për disa shtesa në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019” si dhe Urdhrin nr. 447, datë 31.12.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019”

❖ Hyrje

Referuar nenit 15 të ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Procedura e autorizimit të Organizatave jofitimprurëse është e përcaktuar në VKM nr. 55, datë 6.2.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, procedurë e cila ka përfunduar më datë **10.09.2020**, përmes autorizimit me urdhër të Ministrit të Drejtësisë të **12 (dymbëdhjetë) organizatave jofitimprurëse** dhe konkretisht:

Nr.	Emërtimi i OJF-së	Nr. Data e vendimit të MD për dhënien e autorizimit
1	“Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza”	295 prot., datë 10.09.2020
2	“Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	296 prot., datë 10.09.2020
3	“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara”	297 prot., datë 10.09.2020
4	“Intelektualët e rinj shpresë”	306 prot., datë 10.09.2020
5	“Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijeve në Shëqipëri (CRCA)”	305 prot., datë 10.09.2020
6	“Forumi i Gruas Elbasan”	304 prot., datë 10.09.2020
7	“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	303 prot., datë 10.09.2020
8	“Të ndryshëm dhe të barabartë”	302 prot., datë 10.09.2020
9	“Albanian Legal and Territorial Research Institute (ALTRI)”	301 prot., datë 10.09.2020
10	“Qendra për nisma ligjore qytetare”	300 prot., datë 10.09.2020
11	“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	298 prot., datë 10.09.2020
12	“Qendra Konsumatori Shqiptar”	299 prot., datë 10.09.2020

Bazuar në pikën 14 të VKM nr. 55/2019, **autorizimi** i dhënë nga ministri i Drejtësisë është i vlefshëm për një **periudhë dyvjeçare** (10.09.2020-10.09.2022).

Organizatat jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore kanë të drejtë të përfitojnë përfitojnë financime nga buxheti i shtetit nëpërmjet një procesi konkures dhe transparent përzgjedhje, referuar nenit 15 të ligjit 111/2017, dhe VKM nr.110/2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” e cila përmban në mënyrë të detajuar procedurën që duhet të ndiqet në kuadër të financimit.

Për të aplikuar dhe për të përfituar financime, OJF-të e autorizuara duhet të plotësojnë disa kritere që VKM i ka klasifikuar në kritere të përgjithshme dhe kritere të veçanta, si vijon:

- **Kritere të përgjithshme** (*dhënia e autorizimit nga Ministri i Drejtësisë; të mos ketë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet; të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit me drejtorin e DNJF*);
- **Kritere të veçanta** (*projekt-propozimi i cili përmban të dhënat teknike financiare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtëpërdrejtë; të dhënat për personelin; përvoja në realizimin e shërbimeve të ngjashme*).

VKM nr. 110/2019, përcakton si hapin e parë të procedurës së financimit të OJF-ve të autorizuara hartimin dhe publikimin e **Planit Vjetor të Financimit të OJF-ve të autorizuara**

Konkretisht, në pikën 4 të VKM-së së sipërcituar, parashikohet shprehimisht se: “*Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, brenda 1 muaji nga miratimi i buxhetit, bën publike në faqen zyrtare të saj planin vjetor të financimit që përmban: a) shumën e përfitimit financiar për vitin fiskal; b) objektivat e përfitimit financiar, sipas nevojave të identifikuara; c) numrin e përafërt të organizatave jofitimprurëse të autorizuara që mund të përfshihen në procesin epërzgjedhjes; ç) kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe d) kohën e fillimit të zbatimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti*”.

❖ **Plani Vjetor i Financimit** (sipas elementëve që përcaktohen në VKM 110/2019)

1. *Shuma e përfitimit financiar për vitin fiskal.*

Buxheti i miratuar me VKM nr.897, datë 18.11.2020 ka përcaktuar për dhënien e ndihmes juridike paresore per individet qe plotesojne kushtet, ne zbatim te ligjit per Ndhmën Juridike Falas vlerën prej 4,000,000 lekë si transferata të brendshme dhe për dhënien e ndihmes juridike për gratë dhe vajzat në nevojë që plotësojnë kushtet, në zbatim te ligjit per Ndhmen Juridike vlerën prej 4,000,000 lekë si transferata të brendshme, në total shuma për transferimet e brendshme është në vlerën 8,000,000 lekë.

2. *Objektivat e përfitimit financiar sipas objektivave të identifikuara;*

- a) Dhënia e ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive;
- b) Angazhimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi proaktiv me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas në për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë;

3. *Numri i përfaqësuar i organizatave që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes;*

12 organizata jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë (sipas tabelës më lartë)

4. *Koha e hapjes së thirrjes për aplikime;*

Referuar VKM 110/2019, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas njofton, në faqen zyrtare të institucionit dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, **çdo fillim viti kalendarik.**

Si pasojë, referuar dhe “Roadmap” të dakordësuar, mbi periudhën e hapave proceduriale që duhet të realizohen në kuadër të financimit të OJF-ve të autorizuara, hapja e thirrjes sipas pikës 4 të VKM nr. 110/2019, do të realizohet brenda muajit **Shkurt 2021.**

5. *Koha e fillimit të zbatimit të ofrimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.*

Nëse i referohemi afateve proceduriale të përcaktuara në VKM 110/2019, lidhja e kontratave të financimit parashikohet të realizohet **në fillim të 6 muorit të dytë të vitit 2021.**

Hapat proceduriale si dhe afatet kohore të përcaktuara në VKM e sipërcituar, janë pasqyruar edhe në “Roadmap” mbi financimin e OjF-ve, bashkëlidhur planit të financimit.

ROADMAP MBI FINANÇIMIN E OJF-VE

Vlerësimi/Analiza	Struktura Përgjegjëse	Hapat Proceduriale	Mënyra Veprimit	Afatet Kohore
Plani vjetor i financimit të OjF-ve të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas 1.Drejtoria e Financave, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse; 2.Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore	Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Buxhetin, hartohet plani vjetor i financimit të OjF-ve të autorizuar sipas përcaktimeve të pikës 4 të VKM nr. 110/2019.	Publikimi i planit vjetor të financimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas	Shkurt 2021
Hapja e thirrjes së përgjithshme për financimin e OjF-ve të autorizuar	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas 1.Drejtoria e Financave, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse; 2.Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore	Pas publikimit të planit vjetor të financimit hapet thirrja për financimin e OJF-ve të autorizuar sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 5 të VKM nr. 110/2019	Publikimi i thirrjes në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare	Shkurt 2021
Ngritja e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financimin e OJF-ve; Komisioni i ankimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të	Ministria e Drejtësisë; Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	Përcjellja e shkresave dërguar MD për caktimin e 2 anëtarëve në KVO dhe 2 anëtarëve në KA sipas VKM-së nr.110/2019.	Institucional, shkresor.	Shkurt 2021

procedurës së shqyrtimit si dhe sekretariatit teknik mbështetës.		Ngritja e KVO dhe KA me urdhër të Ministrit të Drejtësisë		
Analizimi i dokumentacionit Teknik/Administrativ të Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara	Komisioni Vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financimin e OJF-ve	Brenda 10 ditëve nga mbyllja e thirrjes publike për aplikim	KVO shqyrton aplikimet për përmbushjen e kriteve të përgjithshme dhe të veçanta	10 ditë mbas mbylljes së thirrjes.
Ndjekja e procedurës së ankimit	Komisioni i ankimimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit	Vlerësimi i ankimimit nëse ka shkaqe ligjore dhe është paraqitur brenda afateve	Nxjerrja e vendimit të arsyetuar për pranimin ose mospranimin e ankimit.	15 ditë nga data e paraqitjes së ankimit. Njofitimi i arsyetuar i vendimit dhe publikimi ë faqen zyrtare të DNJF, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit.
Shpallja e fitueseve	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	Lidhja e kontratës 1 vjeçare të financimit sipas përcaktimeve të pikës 20 të VKM nr. 110/2019 dhe shtojcës të Urdhrit nr. 226, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “ <i>Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti</i> ”	Kontratë individuale për çdo OJF të shpallur fituese pas plotësimit të kriterëve	Prill 2021